

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Gëzim LLulluni, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.V. nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson i autorizuari Xh.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurve Y.G. dhe A.G., të dy nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurve e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.2639/07, të datës 19.12.2012, në seancën jo publike të mbajtur me datë 14.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurve Y.G. dhe A.G. të dy nga fshati ..., Komuna e Prishtinës dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.2639/07, të datës 19.12.2012, përveç në pjesën që ka të bëjë me kamatën në të cilën pjesë NDRYSHOHET dhe vendoset ashtu që DETYROHET të paditurit që paditësit t'ia paguajnë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 19.12.2012, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2639/07, të datës 19.12.2012, në pikën I (një) të dispozitivit pjesërisht e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit A.V., nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, dhe i ka detyruar të paditurit Y.G. dhe A.G. të dy nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material për shkak të lëndimeve të shkaktuara me datë 26.06.2006, në mënyrë solidare t'ia paguajnë dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1.500 Euro, për zvogëlimin e aftësisë së përgjithshme jetësore shumën prej 2.500 Euro, për frikën e pësuar shumën prej 1.500 Euro, të gjitha me kamatë prej 3.5%, që nga data 16.11.2007, e deri në pagesën definitive. Në pikën II (dy) të dispozitivit gjykata e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara dhe atë për dhimbje fizike mbi shumën prej 1.500 Euro deri 2.500 Euro, për zvogëlim të aftësisë përgjithshme jetësore mbi shumën prej 2.500 Euro deri 5.000 Euro, për përjetimin e frikës mbi shumën prej 1.500 Euro deri 2.500 Euro. Në pikën III (tre) të dispozitivit janë detyruar të paditurit që paditësit shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 621,36 euro, t'ia paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënim të përmbarimit forcërisht.

Kundër këtij aktgjykimi të paditurit në afat ligjor kanë paraqitur ankesë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Ankesa e të paditurve i është dorëzuar të autorizuarit të paditësit por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurve është e pabazuar, përveç sa i përket kamatës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A.V. nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, përmes të autorizuarit të tij me datë 16.11.2007, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurve Y.G. dhe A.G. të dy nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material të shkaktuara me datën 26.06.2006, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 10.000 Euro, të gjitha me kamatë prej 3.5%, duke filluar nga data 16.11.2007 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe shqyrtimit e vlerësimit të t'gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2639/07, i datës 19.12.2012, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur me decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar bazën juridike të kërkesëpadisë është vërtetuar me aktgjykimin penal të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr.3038/05, i datës 15.06.2007, sipas të cilit të paditurit Y.G. dhe A.G. të dy nga fshati ..., Komuna e Prishtinës janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar me gjobë me nga 300 Euro, për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 paragrafi 1 pika 4 e lidhur me nenin 23 të KPK-së, pasi që të njëjtit me datën 26.06.2006, rreth orës 10:00 tek Liqeni i Badovcit në Prishtinë, derisa të dëmtuarit A.V. dhe Arsim Llugini ishin duke bërë sigurimin e garave të peshkimit të cilat mbaheshin në liqe, kanë ardhur të pandehurit Y.G. dhe A.G. për tu pastruar në liqe dhe pasi që iu është tërhequr vërejtja nga të dëmtuarit që të mos e pengojnë garën e peshkimit, në këtë rast të pandehurit në bashkëveprim me dashje që t'iu shkaktojnë lëndime të lehta trupore i sulmojnë fizikisht të dëmtuarit duke i goditur me grushta në pjesë të ndryshme të trupit dhe në kokë, me ç'rast të dëmtuarit dëmtuarit Ali i shkaktojnë dërmishje në kokë, kontuzion (ndrydhje) në kokë të përcjella me tronditje të trurit të cilat paraqesin lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë gjykata në procedurën e provave ka nxjerrë ekspertizën mjekoligjore të punuar nga Dr. B.K.-Neurokirurg dhe Dr. N.M.-Psikiatre, në bazë të së cilës është vërtetuar se paditësi ka pësuar lëndime të natyrës së rëndë trupore të cilat janë manifestuar me dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë sepse e ka humbur vetëdijen, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 24 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur 30 ditë për çka dëshmon terapia e ordinuar, dhe dhimbje fizike të intensitetit më të ulët në kohëzgjatje prej 12 muaj.

Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka qenë i shprehur në shkallë prej 5 %, për shkak të komocionit të trurit e që manifestohet me dhembje koke të herë pas hershme, mungesë të koncentrimit, harresës, marramendjes si dhe frikës. Ekspertët kanë vlerësuar se paditësi për shkak të lëndimit ka pësuar frikë primare në momentin e incidentit në formë të frikës nga kërcënimi i integritetit të tij fizik, e cila ka zgjatur disa sekonda deri në momentin e humbjes së vetëdijes, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 ditë, e shoqëruar me gjendje ankthi, pasigurie si dhe zgjime të shpeshta gjatë natës, dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët në kohëzgjatje 3 muaj, ku fillimisht është manifestuar me brengë dhe frikë nga invaliditeti i përhershëm e më pastaj me nervozë, kokë dhembje të herë pas hershme, shqetësime gjatë gjumit kryesisht sindrom e ankthit dhe depresionit.

Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit jo material gjykata e shkallës së parë ka vendosur konform nenit 200 të Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve, e në veçanti duke marrë parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së pësuar, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor si dhe rëndësinë e pjesës së dëmtuar, me ç ‘rast ka konstatuar se shumata e gjykuara janë në përputhje me dëmin e pësuar. Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret është vërtetuar fakti se të paditurit me veprime të kundërligjshme i kanë shkaktuar lëndime trupore si pasojë e të cilave paditësi ka pësuar dëmin e lartcekur, andaj konform dispozitës së nenit 206 paragrafi 1, të LMD-së, gjykata e shkallës së parë i detyroi të paditurit që në mënyrë solidare paditësit t’ia kompensojnë dëmin e pësuar në lartësinë e gjykuara. Në lidhur me mos pjesëmarrjen e të paditurve në seancë, gjykata ka arsyetuar se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt e kjo vërtetohet nga fletë kthesat të cilat gjendjen në shkresat e lëndës, prandaj të paditurit me vetëdije e kanë lëshuar mundësinë që eventualisht ta kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditësit.

Lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jo material, ka arsyetuar se duke u bazuar në ekspertizat mjekësore dhe në praktikën gjyqësore ka gjetur se këto shuma janë mbi vlerën reale të dëmit të pësuar. Sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë gjykata ka vendosur konform nenit 154, 200 dhe 206 të LMD-së, kurse lidhur me kamatën gjykata e shkallës së parë ka vendosur konform nenit 277 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë përveç në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kamatën, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t’paditurve se gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor pa prezencën e t’paditurve duke mos i ftuar në mënyrë të rregullt të njëjtit për seancën e shqyrtimit kryesor. Në shkresat e lëndës gjenden fletë kthesat nga të cilat konstatohet se për seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 19.11.2012, kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt të paditurit të cilët ftesat i kanë pranuar me datë 05.11.2012, dhe mungesën për seancë nuk e kanë arsyetuar. Gjykata e shkallës së parë pasi që ka konstatuar rrethanën se të paditurit janë ftuar në mënyrë të rregullt dhe të njëjtit mungesën nuk e kanë arsyetuar, në pajtim me dispozitën e nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së, ka vendosur që seancën ta mbajë në mungesë të t’paditurve.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, një veprim i tillë procedural i gjykatës së shkallës së parë është përputhje të plotë me dispozitën e sipër cituar të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk është lëshuar në vlerësime të tjera sa i përket shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore meqenëse me ankesë nuk janë ngritur pretendimet tjera ankimore.

Gjendja faktike si bazë ankimore nuk është pretenduar nga ana e ankuesve, ndërsa për të drejtën materiale Gjykata e Apelit ex-officio ka vlerësuar zbatimin e saj nga gjykata e shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve që e ka pësuar paditësi si pasojë e veprimeve të t'paditurve e sidomos zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, natyrën e dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, e duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit (*siç janë: moshë e paditësit, mënyra se si janë manifestuar pasojat e lëndimeve, praktika gjyqësore*), gjen së shumat e gjykuara janë në përputhje të plotë me qëllimin e kompensimit. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që kanë pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket kamatës, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Në këtë rast është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e nenit 277 e LMD-së, pasi që kamata nuk është përcaktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të duhur sepse i ka arsyetuar shpenzimet e gjykuara për secilin veprim të ndërmarrë në procedurën kontestimore, e të cilat veprime edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kanë qenë të domosdoshme në mënyrë që gjykata e shkallës së parë të vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), 200 dhe 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3317/13, me datë 14.09.2016

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v